

VENDIM
Nr.203, datë 16.4.2004

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË OBJEKTIT TË ISH-MAGAZINAVE TË ISH-QENDRËS EKONOMIKE TË ARSIMIT, SARANDË, NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të objektit të ish-magazinave të ish-Qendrës Ekonomike të Arsimit, Sarandë, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, sipas genplanit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministri i Arsimit dhe i Shkencës, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano